

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me date 18.04.2021

SHITËSI - **Znj. Valmira Kenga** , , e lindur më datë 22.02 1985 në Orenj- Librazhd , banues në Tirane, identifikuar me anë të letërnjoftimit nr. I55222021A me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar si Administrator dhe Ortak i Vetem “CONSMINOTTI ” sh.p.k me 100% te kuotave me **NIPT: M11612036B**

BLERESI - **Z.Marco Minotti** lindur në dt. 06.08.1986, qytetar italian me vendlindje ne Novara titullar i Kartës së Identitetit Nr.CA60456DC madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar

BAZA LIGJORE

Referuar dispozitave ligjore

- Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”
- Ligji Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” me ndryshimet e mëvonshme
- Kodi Civil
- Akti i Themelimit e Statuti i Shoqërisë
- Data e rregjistrimit eshte 12/04/2021

OBJEKTI

Mbi bazën e ekstraktit të Shoqërisë “CONSMINOTTI” sh.p.k, shitesi **Znj. Valmira Kenga** , eshte ortaku i cili gezon **100,00 % ta kapitalit te shoqerise me numer pjesesh 1,00 dhe vlere kapitali 100.000,00**

Mbi bazën e dokumentave të sipërcituar, përpilojmë këtë kontratë shitje kuotash me objekt:

- **Shitesi** i shet blesesit 100 % të kuotave që zotëron në **Shoqërine “CONSMINOTTI” sh.p.k**, kundrejt vlerës totale Leke (shtate qind mije leke) ,likujdimi i së cilës do të realizohet në rrugët e parashikuara në ligj në një moment të dytë pas nënshkrimit të kësaj kontrate që do të përcaktohet me mirëkuptim. Ne momentin e neshkrimit te Kontrates Pala blerese merr persiper te gjithe detyrimet qe ka pala shiteses ndaj institucioneve shteterore ose ndaj institucioneve private ose individeve . Palët bien dakort që ky ndryshim të pasqyrohet në QKB pasi kontrata e shitjes se kuotave te regjistrohet ne QKB.

Me hartimin dhe nënshkrimin e kësaj kontrate **Znj. Valmira Kenga** zhvishet nga pronësia si dhe detyrimeve ndaj institucioneve shtetërore ose ndaj institucioneve private ose individeve dhe deklaron se heq dorë nga çdo e drejtë për të kërkuar përfitime të çdo lloji për këtë sasi kuotash, po kështu heq dorë përfundimisht nga çdo pretendim mbi dividendet dhe çdo përfitim tjetër nga aktiviteti i shoqërisë në një masë prej 100 % duke pranuar këtë transaksion.

Ndarje e re e dividendit do të bëhet në masën 100 % per **Z. Marco Minotti**, i cili do te jete **Ortak dhe Administrator i Vetem i shoqerise "CONSMINOTTI" shpk.**

- Mbas nënshkrimit të këtij Akti e pasqyrimit të QKB Shoqëria pëson këto ndryshime:

Ishte:

1. Shoqëria "**CONSMINOTTI**" sh.p.k me Ortakë: **Znj. Valmira Kenga** eshte zotësues i 100% të kapitalit në Shoqërise "**CONSMINOTTI**" sh.p.k.

Bëhet:

1. Në bazë të vendimit, Ortak dhe Administrator i vetem "**CONSMINOTTI**" sh.p.k do te jete **Z. Marco Minotti**, lindur në dt. 06.08.1986, qytetar italian me vendlindje ne Novara titullar i Kartës së Identitetit Nr.CA60456DC madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar me 100% te kapitalit te Shoqerise me vlere nominale te barabarte me 100.000,00 Leke.

SHITËSI

Znj. Valmira Kenga

Valmira Kenga



BLERËSI

Z. Marco Minotti

Marco Minotti

Marco Minotti